



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ**

**PROCESVERBAL**

**KONSULTIMIN PUBLIK MBI HARTIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR  
BARAZINË GJINORE.**

Imbajtur më 11.08.2025, në orën 10:00, në dëgjuesën me banorët të Bashkisë Kamëz, në kuader të projektit të “Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri II”, për “Hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, në Zbatim të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore”.

Takimi u zhvillua në Qendrën Multifunksionale, Valias i Ri.

**Të pranishëm në takim ishin:**

- Drejtoresha e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, znj. Marime Vladi;
- Përgjegjëse për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Barazinë Gjinore, znj. Eralda Allushi;
- Administratorët e Njësive Administrative të Bashkisë Kamëz;
- Përfaqësues të Këshillit Bashkiak;
- Ndërlidhës me komunitetin;
- Shoqeri Civile.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të Përgjegjëses për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Barazinë Gjinore, znj. Eralda Allushi, e cila falënderoi të pranishmit dhe grupin e punës që kontribuan në hartimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore. Ajo theksoi gadishmërinë e Bashkisë Kamëz dhe strukturave të saj për bashkëpunim në kuadër të zbatimit të projektit të “Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri II”, që synon hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë

Gjinore në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.

Më pas, fjala iu dha Drejtoreshës së Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, znj. Marime Vladi, e cila gjithashtu falënderoi të pranishmit dhe Bashkinë Kamëz për bashkëpunimin e pakushtëzuar. Në fjalën e saj, ajo u shpreh: “Jemi këtu për të diskutuar draftin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, ku bashkëpunëtorët, OJF-të dhe të pranishmit mund të japin komentet dhe sugjerimet e tyre, në mënyrë që ky plan të jetë sa më i plotë. Ky dokument është shumë i rëndësishëm, jo vetëm sepse Strategjia Kombëtare kërkon hartimin e tij, por edhe sepse Bashkia Kamëz është një ndër bashkitë e para që ka nënshkruar Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Sot, kjo kartë është nënshkruar nga 24 bashki në vend, por Bashkia Kamza ka qenë ndër të parat.”

Ajo nënvizoi se ky plan nuk ka në fokus vetëm gratë, por edhe burrat, të rejat dhe të rinjtë në gjithëllojshmërinë e tyre. Dokumenti mbështetet në një kuadër të gjerë legjislativ dhe politikash kombëtare.

Gjithashtu, u theksua se hartimi i planit ka ndjekur të gjitha procedurat përkatëse. Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë është ngritur një grup pune, i cili ka analizuar dokumentet, ka përzgjedhur fushat prioritare dhe ka propozuar aktivitete e masa konkrete, të cilat do të ndahen me pjesëmarrësit për të marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre, të cilat janë thelbësore për finalizimin e planit.

### **Fushat e Ndërhyrjes dhe Objektivat Specifike të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025–2030**

- Promovim i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave në të gjithë diversitetin e tyre.
- Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.
- Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave, të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivel vendor.
- Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të rejat, në të gjithë diversitetin e tyre.

- Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.
- Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të mekanizmit të koordinuar të referimit kundër dhunës në familje.
- Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.
- Fuqizimi i grave, të rejave dhe të rinjve për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, përmes promovimit të agjendës “Gruaja, Paqja dhe Siguria” dhe agjendës “Rinia, Paqja dhe Siguria”.
- Integrimi gjinor në politikat vendore.
- Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.
- Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në nivel vendor.

Të gjithë pjesëmarrësve, pa dallim, iu dha mundësia të japin sugjerimet e tyre, si pjesë e një procesi gjithëpërfshirës që synon barazi gjinore dhe përfaqësim të barabartë në hartimin e Planit Vendor të Veprimit.

Drejtoresha e Ndhmës Ekonomike, znj. Marime Vladi dhe grupi i punës falënderuan të pranishmit për kontributin dhe angazhimin e tyre në proces, duke theksuar se të gjitha sugjerimet dhe komentet e dhëna do të merren parasysh, me synimin që të pasqyrohen në draftin përfundimtar të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore.



